
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	<b>ZYRA E PERSONELIT          KANCELARIJA OSOBLJA</b>		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.89/17	Data: 22.06.2017	

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 12, paragrafi 4, të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, , Komuna e Istogut shpall :

### KONKURS

#### Për kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

**Drejtoria:** Drejtoria për Inspekcione

**Vendi i punës :** Inspektor i Veterinës

**Lloji i pozitës:** Marrëveshje për Shërbime të Veçanta ( kohëzgjatja 5 muaj, me mundësi vazhdimi )

**Numri i ekzekutuesve:** 1( një )

**Orari i plotë:** 40 orë në javë

**Paga:** 400 €

#### Detyrat dhe Përgjegjësit:

- Ndërmerr masa për inspektimin e produkteve të mishit, qumështit, bulmetit dhe produkteve tjera;
- Ndërmerr masa administrative dhe masa tjera ndaj personave fizik dhe juridik duke u bazuar në ligjin mbi inspektionin e veterinës;
- Bënë hapjen dhe mbylljen e dhunshme të objektit, për qëllime të inspektimit;
- Bënë marrjen e mallit të dyshimt, apo të prishur ndërsa mallin i cili paraqet rrezik për shëndetin publik e asgjëson, si dhe bëjnë tërheqjen e mallit të dyshimt nga qarkullimi;
- Bënë ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë, pëkatësisht kryerjen e punëve të caktuara, për kohë të caktuar;
- Bënë ndërmarrjen e veprimeve lidhur me mostrat, kontrollojnë produktet me qëllim të verifikimit dhe harmonizimit në pikëpamje sanitare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi ;
- Bënë ndërmarrjen e masave për evitimin e rrezikut për jetë, shëndetin e njerëzve dhe shëndetin e kafshëve apo mbrojtjen e interesit publik;
- Bënë iniciimin e procedurave kundërvajtëse dhe ushtron fletëparaqitjen penale si dhe punë tjera që rrjedhin nga natyra e punës së inspektorit të veterinës, si dhe punë tjera të parashtruara nga mbikëqyrësi.

#### Kualifikimet e nevojshme:

- Diplomë Univerzitare-Fakulteti i Veterinës.
- Të ketë përvojë pune në profesion

**Afati i konkursit :** Afati i aplikimit është 8 ditë, nga shpallja publike në tabelen e shpalljeve dhe në Web faqe të Komunës.

**Dokumentet e kërkua** : Diploma mbi kualifikimin, dëshmi mbi përvojën e punës, dokumenti i identifikimit, ekstrakti i lindjes, dy rekomandime dhe dëshmi që nuk është nën hetime .

**Paraqitja e kërkesave** : Aplikacionet merren në Zyrën e Personelit, kati i III-të, Zyra 304 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

*“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”*

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen

Menaxheri i Personelit  
Fatmir Bytyçi

